



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E INTEGRITETIT, MBIKËQYRJES DHE ANKESAVE
ADMINISTRATIVE E GJYQËSORE
SEKTORI I INTEGRITETIT DHE MBIKËQYRJES**

Lënda: Mbi kërkesën për informacion publik lidhur me procesin e dekriminalizimit

ZNJ. A. K.

Në përgjigje të kërkesës suaj datë 17.12.2023, protokolluar me tonën nr. 6403, datë 22.12.2023, me anën e së cilës kërkon informacion publik lidhur me procesin e dekriminalizimit, Departamenti i Administratës Publike (DAP) ju informon si më poshtë vijon:

Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””, DAP në cilësinë e organit përgjegjës, ka verifikuar të dhënat e deklaruara nga nëpunësit në shërbimin civil dhe në shërbimin diplomatik, si edhe drejtuesit e çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihen në shërbimin civil, dhe ka konstatuar nëse subjekti ka deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me:

- dënime penale me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- dënime penale me vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
- masë sigurimi personal nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
- urdhër kërkimi ndërkombëtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
- dëbime nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

Në vijim, në respektim të pikës 2 dhe 3 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, është kërkuar informacion pranë zyrës së gjendjes gjyqësore dhe zyrës së gjendjes

civile mbi gjeneralitetet aktuale dhe të mëparshme, si edhe gjendjen gjyqësore të çdo subjekti vetëdeklarues.

Bazuar në informacionin e përcjellë nga këto institucione si edhe të dhënave të deklaruara në formular nga subjekti, organi përgjegjës DAP:

- a. nëse konstaton se ndonjë nga të dhënat përfshihet brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, ndërpret verifikimet e mëtejshme dhe aplikon masat e parashikuara nga ligji për pengimin e zgjedhjes ose emërimit, apo largimit, nga funksioni publik të personit;
- b. nëse konstaton prima facia se të dhënat nuk përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, ia kalon rastin për kontroll të thelluar, brenda 5 ditëve, Prokurorisë së Përgjithshme, për të verifikuar saktësinë e të dhënave të pasqyruara dhe për të konstatuar nëse rrethanat janë të ndryshme dhe se personi është subjekt i ndalimeve, sipas ligjit.

Në çdo moment organi përgjegjës DAP kërkon, brenda 5 ditëve, verifikimin e plotë nga Prokuroria e Përgjithshme të deklarimeve të bëra kur ka indicie mbi bazën e një kërkesë, ose kryesisht kur ka të dhëna apo fakte, përfshirë ato të njohura botërisht për ekzistencën e të dhënave të përcaktuara në pikën 3, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Theksojmë se, procesi i verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjektet e parashikuara në shkronjën “gj”, të pikës 4, të kreut II, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë realizohet nga organi përgjegjës DAP në bashkëpunim me institucionet e përfshira në këtë proces. Në çdo rast organi përgjegjës DAP, pas vendimmarrjes së Prokurorisë së Përgjithshme, brenda afateve ligjore të përcaktuara ka vijuar me përcjelljen e rezultateve të verifikimit pranë institucionit përkatës, në të cilin kandidon apo është emëruar subjekti, institucion ky i cili ka detyrimin për zbatimin e masave për pengimin e zgjedhjes ose emërimit apo largimit nga funksioni publik të personit.

Nga viti 2016 e në vijim, organi përgjegjës DAP në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin e sipërcituar, ka vazhduar me procesin e verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjektet në formularët e vetëdeklarimit, të dhëna të cilat pas kontrollit të tyre janë të pasqyruara në tabelën si më poshtë vijon:

	Numri Total	Nëpunës në shërbimin civil	Nëpunës në shërbimin diplomatik	Drejtuës të çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihen në shërbimin civil
Subjekte të përcjellë për verifikim të plotë/kontroll të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët kanë qenë në detyrë deri më datë 04.05.2016	584	351	1	232
Subjekte të përcjellë për verifikim të plotë/kontroll të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët janë emëruar pas datës 04.05.2016	60	38	0	22
Subjekte të përcjellë për verifikim të plotë/kontroll të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme, periudha Mars 2017 - Mars 2018	46	18	0	28
Subjekte të përcjellë për verifikim të plotë/kontroll të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme, periudha Prill - Dhjetor 2018	61	38	0	23
Subjekte të përcjellë për verifikim të plotë/kontroll të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme, periudha Janar - Dhjetor 2019	77	53	0	24
Subjekte të përcjellë për verifikim të plotë/kontroll të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme, periudha Janar - Dhjetor 2020	55	28	0	27
Subjekte të përcjellë për verifikim të plotë/kontroll të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme, periudha Janar - Dhjetor 2021	70	54	0	16
Subjekte të përcjellë për verifikim të plotë/kontroll të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme, periudha Janar - Dhjetor 2022	68	40	0	28

Lidhur me informacionin e kërkuar nga ana juaj për funksionarët publikë, të cilët nuk deponuan formularin e vetëdeklarimit, brenda afateve ligjore të përcaktuara nga legjislacioni sipërpërmendur, pas verifikimit të realizuar të dhënat rezultojnë si më poshtë:

	Numri Total	Nëpunës në shërbimin civil	Nëpunës në shërbimin diplomatik	Drejtuës të çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihen në shërbimin civil
Funksionarë publikë në detyrë që nuk deponuan formularin e vetëdeklarimit, brenda afateve ligjore të përcaktuara nga legjislacioni	97	33	0	64

Gjithashtu sikurse jeni në dijëni, në zbatim të detyrimeve, të përcaktuara nga legjislacioni i sa më lartë cituar, në faqen zyrtare të DAP gjëni të publikuar:

- ✓ Listën e subjekteve vetëdeklarues që kanë depozituar formular vetëdeklarimi, pranë organit përgjegjës DAP, nga viti 2016 e në vijim, në linkun <https://www.dap.gov.al/publikime/formulare>;
- ✓ Listën e subjekteve vetëdeklarues të cilët pas verifikimit, janë konstatuar në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik, sipas ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, në linkun <https://www.dap.gov.al/images/documents/Subjekte%20te%20Konstatuar%20ne%20Kushtet%20e%20Ndalimit%20e%20Ushtrimit%20e%20Funksionit.pdf>;
- ✓ Raportet vjetore të DAP, në linkun <https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, informacioni i mësipërm gjenerohet nga të dhënat e administruara nga DAP në përmbushje të detyrave të veta funksionale, e për rrjedhojë për çdo paqartësi tuajën lidhur me të dhënat e marra nga palë të treta, lutemi drejtojuni autoritetit përkatës, i cili jua ka vënë në dispozicion.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,